



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	07.06.2018
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës - Muaji Maj 01.05.2018-31.05.2018

Muaji Maj në drejtorinë tonë është karakterizuar me punë, angazhime dhe aktivitete të ndryshme:

Më datë **11.05.2018** ka përfunduar viti shkollor për nxënësit maturant.

Është realizuar mbrëmja e maturës për nxënësit maturant të 3 shkollave të mesme të Komunës sonë.

Mbajtja e testit të arritshmërisë më datë **18.05.2018**, test të cilit ju nënshtruan **1032** nxënës.

Kërkesë Drejtoratit të Shërbimeve Publike për hartimin e paramasës dhe paralogarisë për:

- Rregullimin e infrastrukturës në Shfmu “Zenel Hajdini” në Gadime, p.n.f në Gllavicë-Marevc,
- Dëmet e shkaktuara nga të reshurat në Shfmu “Emin Duraku” në Banullë dhe p.n.f në Qallapek.

Kërkesë Departamentit të Prokurimit për zhvillimin e procedurave të prokurimit për:

- Furnizimin me dyer për SHML Gjinnazi “Ulpiana” në Lipjan,
- Realizimin e transportit për administruesit e testit të Maturës nga Komuna jonë në Komunën e Ferizajit për dy ditët e testimit,
- Demolimin e dyshemes ekzistuese, nivelizimi, furnizimi me laminat dhe montimi i tij në Çerdhen në Lipjan,
- Rregullimin e infrastrukturës në p.n.f Gllavicë-Marevc,
- Ndërtimin e shkollës Shfmu “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë, p.n.f në Brus,
- Riparimet e nyjeve sanitare në Shfmu “Zenel Hajdini” në Gadime.

Kërkesë Departamentit të Buxhetit dhe Financave për buxhet shtesë në afatin e rishiqimit të buxhetit.

Planifikimi i buxhetit në të gjitha kategoritë shpenzuese për projeksionin 2019-2021:

- a) Paga dhe medijtje të rregullta, pagat jubilarë, përcjellëse,
- b) Mallra dhe shërbime,
- c) Komunali dhe
- d) Kapitale.

Kërkesë MASHT-it, MEF-it për: implementimin e investimeve kapitale në projeksionin buxhetor për vitin 2019-investime kapitale në kuadër të buxhetit të MASHT-it:

- Ndërtimi i shkollës në fshatin Ribar i Madh,
- Ndërtimi i sallës së sporteve në Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan,
- Renovimi i terësishëm i Shfmu “Katër Dëshmorët” në Krojmir dhe
- Renovimi i sallës së sporteve në Shfmu “Zenel Hajdini” në Gadime.

Kërkesë Departamentit të Planifikimit dhe Urbanizmit për hartimin e paramasës dhe paralogarisë për riparimin e ngrohjes qendrore në Shfmu “Zenel Hajdini” në Gadime, Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan dhe Shfmu “Drita” në Rubovc, p.n.f në Kojskë.

Është bërë furnizimi i disa shkollave me inventar dhe gjeneratorë.

Kemi filluar me planifikimin dhe përgatitjet administrative-teknike për furnizimin e nxënësve me tekste shkollore për vitin **2018/2019**.

Nënalokimi në kategorinë Paga&medijtje.

Zotimi i mjeteve në kategorinë Mallra/Shërbime dhe Komunali.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.